

*Specialist pranë Sektorit të Monitorimit të Incidenteve Kibernetike, Drejtoria e AL-CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike*

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Aktit Normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave, Nr.15, Datë 13.10.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9880, Datë 25.02.2008, "Për Nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, VKM-së Nr.141, datë 22.02.2017 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 2 (dy) vende të lira pune në pozicionin:

- **Specialist pranë Sektorit të Monitorimit të Incidenteve Kibernetike, Drejtoria e AL-CSIRT në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

1. Realizon detyrat në përputhje politikat, procedurat dhe udhëzimet e CSIRT Kombëtar;
2. Zbaton në nivel të lartë të gjitha detyrat e caktuara nga eprori dhe argumenton punën profesionale që ka kryer;
3. Merr pjesë në grupin e punës për monitorimin e Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit në lidhje me evidentimin e dëmeve dhe mangësive në zbatimin e standardeve teknike;
4. Merr pjesë në ngritjen e sistemeve të sigurisë, në analizat e informacioneve, sistemeve etj, duke propozuar masat mbrojtëse, si dhe mbledh statistikat;
5. Ndihmon në përgatitjen e propozimeve për përmirësime në fushën e legjislacionit për sigurinë kibernetike dhe hartimin e rregullave të sigurisë;
6. Mbledh, monitoron dhe përpunon në mënyre të vazhdueshme informacione për zhvillimet e reja teknologjike , sulmet dhe masat mbrojtëse ndaj tyre;
7. Me autorizim të eprorit bashkëpunon në fushën e sigurisë kibernetike me institucionet e tjera shtetërore, sektorin privat dhe ato ndërkombëtare.

**KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

- Të zotrojnë diplomë të nivelit "Master Profesional" në Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi shumë të mira në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë reale;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;
- Përparësi çertifikime profesionale në: Certifikata në administrim rrjetash/ Menaxhim sistemesh/IT security/LINUX/Penetration Test;

**PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-b)**

## **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 08.11.2022, në adresën e e-mailit [burimet.njerezore@cesk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@cesk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.